



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1019/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit GNTC Group Sh.A me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.M., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.336/23 të datës 13.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.01.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit GNTC Group Sh.A me seli në Prishtinë, e datës 13.09.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.336/23 i datës 13.06.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa ka mbetur në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/19408, i datës 06.12.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit të Konfliktit Administrativ dhe KDAK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit ta gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit, të anulohet aktgjykimi kontestues, ose të priset aktgjykimi kontestues dhe i njëjti i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i

zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. nr.01.3.2.2/19408 të datës 06.12.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, GNTC Group Sh.A Veternik - Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr.03.1.7-2021-1277 të datës 23.09.2021, të Sektorit për Kundërvajtje Doganore.

Gjykata e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/19408 të datës 06.12.2021, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 13.06.2023, në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, 01.3.2.2/19408 të datës 06.12.2021. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se “Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet tjera të paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi. Pretendimin e paditësit se pala deklaruese është e lajthitur pasi që obligimi apo deklarimi është bërë konform shtetit eksportues ku në rastin konkret kemi të bëjmë me një shtet kryesor të BE-së ku gabimi është bërë nga ta, Gjykata nuk e pranon si të drejtë për faktin se paditësi DUD-at nr. R-31150/01.05.2021, R-31149/01.05.2021, R-31147/01.05.2021, R31145/01.05.2021, R-31141/01.05.2021, R-31134/01.05.2021, R-31129/01.05.2021, i ka deklaruar vet me preferencë MSA, dhe me normë të taksës doganore 1%, e për aplikimin e të cilës kërkohet dëshmia mbi origjinën e mallit, dëshmi kjo që ka rezultuar negative pas konfirmimit të shtetit gjerman lidhur me preferencën e aplikuar si në faturat e DUD-ve si më lartë. Gjykata ka konstatuar se e paditura e ka ndëshkuar paditësin me gjobë administrative në shumë 9,000.00€ për shkak se paditësi duke mos deklaruar saktë origjinën e mallit lëndor kontestues, dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 276 pika (k) të kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës në të cilin theksohet se : *“Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshinë tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumën prej pesëmijë (5,000.00) deri në dhjetëmijë (10,000.00), bazuar në nenin 9 të Ligjit Nt.04/L/099 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave sipas të cilit për të gjitha shkeljet e parapara në nenin 276 do të gjobitet me gjobë në të holla në shumën prej pesëqind deri në dhjetëmijë (10,000.00) Euro”*. Gjykata konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura por edhe para gjykatës të ofrojë prova konkrete për të vërtetuar origjinën e mallit të deklaruar, respektivisht certifikatën EUR1 ose deklaratën faturë përkatëse reale për këto import, e cila edhe pas verifikimeve të bëra është dashur

të rezultojë pozitive. Tutje pala paditëse nuk ka pretendime ankimore lidhur me lartësinë e gjobës. Pala paditëse nuk ka paraqitur dëshmi lidhur me kundërshtimin e obligimit për pagesë të detyrimeve doganore shtesë, pas mos pranimit të preferencës MSA sipas DUD-ve kontestues nr. R-31150/01.05.2021, R-31149/01.05.2021, R-31147/01.05.2021, R-31145/01.05.2021, R-31141/01.05.2021, R-31134/01.05.2021, R-31129/01.05.2021, fakt ky që do të përcaktonte edhe bazën eventuale për kundërvajtje doganore në këtë rast.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Gjykata e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes, për faktin se e paditura ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Kodit Doganor me rastin e nxjerrjes së aktvendimit të lartcekur, këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë ka gjetur se paditësi ka dështuar të prezantoj provat si certifikatën e origjinës ose deklaratën faturë të konfirmuara nga shteti eksportues, për mallin sipas DUD-ve kontestues, e me të cilën do të mbështeste pretendimet e tij si në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë.

Gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe

besueshmërinë provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, sepse, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Gjykata e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

K.DH.SH.II.nr.1019/23, me datë 18.01.2023

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi**